

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR

Nr. Prot: 31
Org. Jedinica: 01B
Prot. No.:
Nr. i faqeve: 2
Br. stranica:
No. pages:
Prishtinë / a
Datum: 13/01/2021



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës/ Ministry of Education and Science/
Ministarstvo za Obrazovanje i Nauku

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01B-01

Datë: 13.01.2021

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L – 113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare nr. 7/01, mars 2019), neni 11 i Ligjit Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 7 / 26 Mars 2013), neni 8, paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 6/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e datës 06.06.2020, neni 4 të Rregullores shtojcës 11 të (QRK) – nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) – nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e datës 16.06.2020, nxjerr:

VENDIM

Për zbatimin e kurrikulave për profilet:

1. Në lëminë e shëndetësisë:

- 1.1. Teknik i optikës
- 1.2. Teknik i ortoprotetikës
- 1.3. Teknik dentar
- 1.4. Teknik i farmacisë
- 1.5. Audiometrist
- 1.6. Asistent i ortopedisë
- 1.7. Asistent i kujdesit social shëndetësor
- 1.8. Asistent i sigurisë ushqimore dhe dietave
- 1.9. Asistent i fizioterapisë

2. Në lëminë e ekonomisë:

- 2.1. Nëpunës banke
- 2.2. Nëpunës finance

- 2.3. Nëpunës marketingu
- 2.4. Nëpunës industrie
- 2.5. Nëpunës për zhvillimin e burimeve njerëzore
- 2.6. Administrim zyre

3. Në lëminë e tregtisë:

- 3.1. Tregti me pakicë dhe shumicë
- 3.2. Shërbime ndaj konsumatorit dhe shitjes
- 3.3. Nëpunës eksport-import

4. Në lëminë e turizmit:

- 4.1. Udhëheqës i udhëtimeve dhe grupeve turistike
- 4.2. Asistent në zyra informimi dhe agjenci turistike
- 4.3. Asistent në organizimin e ngjarjeve (eventeve).

5. Të zbatohen kurrikulat e të gjitha profileve të listuara më lartë në Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional;

- 5.1. Kurrikulat e të gjitha profileve të listuara më lartë i takojnë nivelit 3 dhe 4 të Kornizës së Kualifikimeve të Kosovës;
- 5.2. Kurrikulat e të gjitha profileve të listuara më lartë i takojnë shkallës 5 dhe 6 të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës;
- 5.3. Kurrikulat e të gjitha profileve të listuara më lartë zbatohen në nivelin I dhe II të Arsimit Profesional;
- 5.4. Kurrikulat e të gjitha profileve të listuara më lartë zbatohen për klasët 10, 11 dhe 12 të Arsimit Profesional.

6. Kurrikulat e lartshënuara për lëminë e shëndetësisë janë në zbatim që nga viti shkollor 2013/2014, ndërsa për lëmitë e ekonomisë, tregtisë dhe turizmit që nga viti shkollor 2014/2015.

7. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim: Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara si dhe nevojës për zbatimin e kurrikulave të profileve të listuara më lartë në Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. DKA-ve;
2. Kabinetit të Ministrit / MASH;
3. Zyrës së SP / MASH;
4. Sektorit të AAP-së;
5. Arkivit.

